



Funded by  
the European Union

## THIRRJE PËR APLIKIM: GRANTE HULUMTUESE PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS 'Çështjet sociale dhe personat LGBTI+'

Numri i granteve të vogla hulumtuese për studentë: Pesë (5) grante

### Lidhur me projektin

#### Detaje mbi skemën e granteve të vogla hulumtuese për studentë:

Përmes kësaj thirrjeje, ftohen studentët e Fakultetit Filozofik në kuadër të Universitetit të Prishtinës, shtetas/e të Republikës së Kosovës për të aplikuar në skemën e granteve të vogla hulumtuese prej 500 Eurosh. Kjo thirrje hapet me qëllim të rritjes dhe zhvillimit të hulumtimit mes studentëve që janë të interesuar në fushën e çështjeve LGBTI+. Në kuadër të këtij aktiviteti do të ndahen pesë grante hulumtuese për studentë të Universitetit të Prishtinës, një grup nga 2-3 persona.

Studentët përfitues të granteve do të kenë mundësi që pas përzgjedhjes të marrin pjesë në një punëtori të udhëhequr nga njohës dhe praktikues të fushës në atë se si duhet të trajtohet hulumtimi në këtë fushë, kornizat dhe qasja metodologjike, t'i caktohet mentorë që do punojnë me studentët si dhe të publikohet puna e tyre në një raport të përbashkët. Secili përfitues/e duhet që projektin e tij/saj hulumtues t'a përfundojë brenda periudhës së definuar sipas tabelës në fund të thirrjes, duke iu përmbajtur buxhetit prej 500 eurosh për grup.

#### Llojet e aktiviteteve hulumtuese (temat)

Temat, në kontekstin e Kosovës, që inkurajohen të hulumtohen por nuk kufizohen janë:

- Historia e Lëvizjes LGBTI+ në Kosovë
- Të drejtat dhe mbrojtjet ligjore për individët LGBTI+ në Kosovë
- Shëndeti dhe mirëqenia e personave LGBTI+ në Kosovë
- Edukimi dhe Ndërgjegjësimi për Çështjet LGBTI+ në Kosovë
- Përfaqësimi i personave LGBTI+ në mediat dhe kulturën popullore të Kosovës
- Ndërsektorialiteti brenda komunitetet LGBTI+ në Kosovë
- Familja dhe Marrëdhëniet në Komunitetet LGBTI+ në Kosovë

Implemented  
by:



CENTER FOR EQUALITY AND LIBERTY  
KOSOVA



Funded by  
the European Union

## Si të aplikoni?

Për të aplikuar, së bashku me dokumentet e listuara më poshtë, ju duhet të dorëzoni një projekt propozim të hulumtimit me 500-800 fjalë, duke respektuar standardet e shkrimit akademik, në të cilën përshkruani arsyen për temën e zgjedhur dhe synimin. Projekti hulumtues, kur të finalizohet, duhet që të jetë 3000 - 5000 fjalë dhe të mos dallojë në përmbajtje nga projekt propozimi me të cilin është aplikuar.

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë si në vijim:

- Dëshmia që jeni student/e Universitetit të Prishtinës që nxirret nga SEMS (pa vulë)
- CV

Dërgoni dokumentet e mësipërme në [info@cel-ks.org](mailto:info@cel-ks.org) me subjekt “Aplikim për grante hulumtuese”:

SKEMA E VOGËL PËR GRANTE HULUMTUESE	
Procesi	Datat
Hapja e thirrjes dhe publikimi në kanalet digjitale	31.07.2024
Afati i fundit për aplikim	31.08.2024
Informimi mbi të përzgjedhurit	05.09.2024
Dhënia e granteve të vogla hulumtuese përfituesve	TBC
Afati i fundit për dorëzim të punimeve hulumtuese	TBC
Publikimi i hulumtimeve	TBC

Implemented  
by:



CENTER FOR EQUALITY AND LIBERTY  
KOSOVA